

V E N D I M
Nr.242, datë 28.5.1999

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË PËRGATITJES, ADOPTIMIT, MIRATIMIT DHE
ZBATIMIT TË STANDARDEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Kodit të përgatitjes, adoptimit, miratimit dhe zbatimit të standardeve.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

KODI I PËRGATITJES, ADOPTIMIT, MIRATIMIT DHE ZBATIMIT TË STANDARDEVE

1. Organi i standardizimit, gjatë hartimit të standardeve, trajton në mënyrë jo më pak të favorshme se produktet e vendit, produktet e njëjta të çdo vendi anëtar të OBT-së dhe të çdo vendi tjetër.

2. Organi i standardizimit siguron që standardet që përgatiten, adoptohen ose zbatohen, të mos krijojnë pengesa të panevojshme për tregtinë ndërkombëtare.

3. Në rastet kur ekzistojnë standarde ndërkombëtare dhe adoptimi i tyre është i pashmangshëm, organi i standardizimit, të përdorë ato ose pjesë të rëndësishme të tyre, si bazë për standardet që ai përgatit, duke përjashtuar rastet kur standardet ndërkombëtare ose pjesë të tyre janë jo efektive ose të papërshtatshëm, për shkak të nivelit të pamjaftueshëm të mbrojtjes, faktorëve bazë klimaterikë, gjeografikë ose problemeve me bazë teknologjike.

4. Për harmonizimin e standardeve në maksimumin e mundshëm, organi i standardizimit, brenda mundësive të tij, merr pjesë në përgatitjen e atyre standardeve ndërkombëtare, nga organizatat përkatëse ndërkombëtare, për të cilat ai gjykon se janë në proces ose do të adoptohen si standarde kombëtare. Në rastet kur ka më shumë se një organ kombëtar standardizimi, pjesëmarrja bëhet me një delegacion ku përfaqësohen të gjithë këto organe standardizimi.

5. Organi i standardizimit brenda territorit të një vendi anëtar, merr masa për të evituar çdo dublim ose shkelje kompetencash me organet e tjera në territorin e tyre ose me punën e organeve ndërkombëtare apo rajonale të standardizimit. Ai merr masa për të arritur një konsensus për standardin që përgatitet. Të njëjtën gjë bëjnë edhe organet rajonale të standardizimit, përkundrejt organeve homologe ndërkombëtare të standardizimit.

6. Sa herë që është e mundur, organi i standardizimit harton standardet duke u mbështetur në vetitë e produkteve dhe jo në anën përshkrimore të tyre.

7. Të paktën çdo 6 muaj, organi i standardizimit boton një program pune i cili përmban emrin e adresën e tij, standardet që aktualisht po përgatiten dhe listën e standardeve që ka adoptuar në periudhën e mëparshme. Standardi konsiderohet në përgatitje e sipër që nga momenti që është marrë vendimi për përgatitjen e tij dhe derisa të miratohet. Titujt e projektstandardeve, sipas kërkesës duhet të jepen në anglisht ose frëngjisht, kur kjo kërkohet. Ekzistenca e programit të punës njoftohet në një botim kombëtar ose rajonal të organeve të standardizimit. Programi i punës duhet të tregojë për çdo standard, në përputhje me rregullat e ISONET-it, klasifikimin

përkatës, në çfarë niveli është puna për hartimin e standardit dhe referencat e çdo standardi ndërkombëtar të marrë për bazë, si dhe mënyrën se si mund të kërkohet nga të interesuarit. Me t'u botuar ky program njoftohet Qendra e Informacionit e ISO/IEC-it në Gjenevë. Njoftimi përmban emrin dhe adresën e organit të standardizimit, botimin ku programi ka dalë, periudhën të cilës i përket, çmimin nëse ka dhe si mund të sigurohet. Njoftimi mund t'i bëhet direkt Qendrës së Informacionit ISO/IEC në Gjenevë ose nëpërmjet organit kombëtar që është anëtar i ISONET-it.

8. Organi kombëtar anëtar i ISO/IEC-it merr masa që të bëhet anëtar i ISONET-it ose të caktojë një organizëm tjetër, në nivelin më të lartë të anëtarësisë. Organet e tjera të standardizimit marrin masa për t'u bërë anëtarë shok të ISONET-it.

9. Përpara adoptimit të një standardi, organi i standardizimit lejon një periudhë të paktën 60 ditore për komente në lidhje me projektstandardin nga palët e interesuara në territorin e një vendi anëtar të OBT-së. Kjo periudhë mund të shkurtohet në rastet kur dalin probleme urgjente që lidhen me sigurinë, shëndetin ose mjedisin. Jo më vonë se fillimi i periudhës së komenteve, organi i standardizimit njofton periudhën e komenteve sipas paragrafit 7. Njoftimi përfshin edhe devijimet përkatëse nga standardet ndërkombëtare.

10. Sipas kërkesës së bërë nga çdo palë e interesuar brenda territorit të një vendi anëtar të OBT-së, organi i standardizimit, i jep menjëherë ose merr masa për t'i dhënë, një kopje të projektstandardit i cili është lënë për komente. Çdo pagesë për këtë shërbim është i njëjtë si për subjektet e vendit, ashtu edhe për ato të huaja, me përjashtim të kostos reale të dërgimit.

11. Gjatë përpunimit të mëtejshëm të standardit, organi i standardizimit, merr parasysh komentet që janë bërë gjatë periudhës së caktuar për këtë qëllim. Komenteve, që janë marrë nga vendet që kanë pranuar këtë Kod, ju jepet përgjigje menjëherë, nëse kjo gjë kërkohet. Përgjigja përmban shpjegimin përse një devijim nga standardi përkatës ndërkombëtar është i nevojshëm.

12. Sapo standardi është adoptuar ai botohet menjëherë.

13. Sipas kërkesës të bërë nga çdo palë e interesuar brenda territorit të një vendi anëtar të OBT-së, organi i standardizimit i jep menjëherë ose merr masa për t'i dhënë një kopje të programit të punës ose të një standardi, i cili është përgatitur. Çdo pagesë për këtë shërbim është e njëjtë si për subjektet e vendit ashtu edhe për ato të huaja.

14. Organi i standardizimit bashkëpunon dhe u ofron të gjitha mundësitë homologëve të tij, për zbatimin e këtij Kodi. Ai merr masa për të zgjidhur çdo ankesë.